

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"As Netflix s'do ta imagjinonte. Skenar apokaliptik"/ Artan Hoxha për skandalin e Vlora Hysenit: Kjo që ndodhi me SHISH-in nuk do ta arrinte as një shërbim armik
ADRESA	https://piranjat.al/politike/as-netflix-sdo-ta-imagjinonte-skenar-apokaliptik-artan-hoxha-per-skanda-i106202
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 15:31:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 15:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	09f40952852b0da857ec620ef082c0eba2c1f163b6b2bd345e70f949bad1baef
TEKSTI	c012e74cb45a42dc2c6993d1d3c14787b4e70bc3bf1138232eef819a1276cb84
PAMJA	5468643f0086787d716d553c488ff995b0a13169021180b6aad4ca7702417d94

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	aecf1d7c204bf1f9f5f9ceefd4000759fe223d4e4a415e687139a55798b6edc6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/aecf1d7c204bf1f9f5f9ceefd4000759fe223d4e4a415e687139a55798b6edc6

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: [ne Elbasan, bllokohet](#) ■ [Elbasan. Për shkak të](#) ■ [Zbardhet ngjarja](#) ■ [Kë përfunduar me të shtrëna](#) ■ [Gramshit plagosen](#) ■ [automjete janë përplasur](#) ■ [të ri të SHBA-ve në](#) ■ [Shteteve të Bashkuara të Amerikës në](#) ■ [motër që humbën](#) ■ [motër e vëlla, të cilët](#) ■ [rikthehe](#) ■ [në](#)

POLITIKE

“As Netflix s’do ta imagjinonte. Skenar apokaliptik”/ Artan Hoxha për skandalin e Vlora Hysenit: Kjo që ndodhi me SHISH-in nuk do ta arrinte as një shërbim armik

Piranjat Përditësimi i fundit 26 Shtator 2026, 17:17



Gazetari Artan Hoxha ka komentuar në emisionin “Kjo Javë” në News24, me gazetaren Nisida Tufa, arrestimin e ish-drejtores së SHISH, Vlora Hysenit, duke e cilësuar situatën si një nga goditjet më të rënda ndaj institucionit të inteligjencës shqiptare. Hoxha tha se niveli i depërtimit të krimit të organizuar në strukturat shtetërore, sipas tij, ka kaluar çdo skenar që mund të imagjinohej.

Nisida Tufa: Ish-kreu i SHISH është tashmë në arrest shtëpie. Si e komentoni?

Artan Hoxha: Ka ndodhur kaq shumë gjëra kohët e fundit, sa është normalizuar edhe skandali më i madh. Pra kemi shkuar në fazën që po kthehemi dalëngadalë të pandjeshëm. Nuk na çudit asgjë. Jo se s’i kemi ditur, i kemi denoncuar, tashmë i shohim dhe me prova dhe prapë na duket e pabesueshme. Pra, asnjëherë nuk e kam menduar që gjatë gjithë karrierës që unë kam, pak 30 vjet si gazetar, që nuk e kam menduar kurrë që një krim i organizuar mund të shkonte deri në nivele të tilla.

Shërbimi informativ, fillimisht SHIK, pra Shërbimi Informativ Kombëtar dhe pastaj SHISH, Shërbimi Informativ Shtetëror, ato kanë pasur historinë e vet, kanë pasur periudha që statusi i tyre ishte shumë i rëndësishëm. Ata ishin me shumë peshë, ishin shumë të frikshëm, kryenin vërtet operacione të cilat edhe sot e kësaj dite kanë lënë pasojë, janë deri me shoqërime, rrëmbime, torturime, deri dhe zhdukje njerëzish kanë bërë.

Por organi ka qenë represiv, sigurisht, në shërbim të atij që mund të ishte në pushtet, por nuk ka qenë i kapur nga krimi i organizuar.

Sa më tepër që Shërbimi Informativ e ka kryesisht punën me shërbimet armike...

Nisida Tufa: Po pra, nëse mbështetet te shërbimet partnere, të cilët janë aleatët e Shqipërisë, detyra kryesore e tij është ta mbrojë vendin nga kërcënimi që i vjen...

Artan Hoxha: Nga vendet armike. Dhe ne, për fatin tonë të keq, i kemi shumë afër armiq të natyralë, të cilët herë pas here duan të na dëmtojnë. Diku i arrijnë qëllimit, diku dështojnë, por janë permanent në sulmin që i bëjnë vendit tonë për ta dobësuar, edhe si demokraci, edhe si shoqëri, edhe si shtet. Por unë besoj që as në ëndrrat më të mëdha që mund të kenë kaluar nëpër mend shërbimet e vendeve armike, nuk besoj që do të mendonin të realizonin një operacion të tillë që t’i shkaktonin shërbimit tonë shtetëror një katastrofë të këtij niveli.

Pra, edhe sikur Federata Ruse, ku di unë, shërbimi serb, shërbimi grek, shërbimi iranien të bëheshin bashkë dhe të përdornin të gjitha energjitë e tyre, burimet financiare, burime njerëzore, teknologjike për t’i shkaktuar Shqipërisë këtë gjë, unë besoj që nuk do ta kishin arritur. Dhe këtë gjë pra nuk e arrijnë gjithë këto shërbime të mëdha, me famë globale, pra famë të keqe, dhe e arrijnë shërbimi i Sukhtit, shërbimi i Xhavzotajt, i Hamillajt. Pra duket në një skenë, domethënë, apokaliptike.

Unë nuk e di, edhe për dashamirësit e Netflix-it që shohin ato serialet “Narcos”, nuk besoj që regjisorëve të famshëm atje do t’u shkonte në mendje ta bënin fiction një gjë të cilën ne e bëmë në realitet.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 26 Shtator 17:11

[Heshtja e Ramës në OKB për Kosovën/ Bardhi: Histori e turpshme që s’duhet të kalojë në heshtje!](#)

Për kreun e grupit parlamentar të PD, Gazment Bardhi, Edi Rama po e përdor Kosovën për propagandë ditore, pas heshtjes së k&e...

POLITIKE 26 Shtator17:02

Komisioni Hetimor për zgjedhjet e 11 majit, PD kërkon nisjen e procedurave: Vendimi i Kushtetueses është detyrues

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i kërkon kryetarit të Kuvendit, zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për ngritjen e...

POLITIKE 26 Shtator16:54

Nga NATO te misionet në Afganistan dhe Jeruzalem, kush është Eric Wendt, ambasadori i ri i SHBA-së në Shqipëri

Gjenerallejtënant në pension i Forcave Speciale amerikane, Eric Wendt, merr zyrtarisht sot detyrën e ambasadorit të ri të Shteteve të...

POLITIKE 26 Shtator16:13

Ambasadori i ri në Tiranë, Ambasada Amerikane: Çojmë përpara përparësitë e administratës Trump

Ambasada e SHBA në Tiranë ka reaguar pasi Eric Wendt mori zyrtarisht detyrën, duke dorëzuar letrat kredenciale te Bajram Begaj në Palla...

POLITIKE 26 Shtator14:30

Berisha i uron mirëseardhjen ambasadorit Eric Wendt: SHBA do japë ndihmë substanciale për çmontimin e narkoshtetit

Kryetari i PD, Sali Berisha në bashkëbisedimin me qytetarët në rrjetet sociale, ka komentuar ardhjen e ambasadorit të ri të Shteteve...

POLITIKE 26 Shtator13:39

Xhixho: 400 miliardë lekë në vit në ndërtim, nga vijnë këto para?

Erisa Xhixho ngre pikëpyetje mbi burimin e parave që financojnë sektorin e ndërtimit në Shqipëri, duke iu referuar një qark...

POLITIKE 26 Shtator13:36

Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë dhe...

Sali Berisha ka zhvilluar një komunikim me qytetarët, ku ka komentuar zhvillimet e fundit politike dhe aktivitetet e Partisë Demokratike në...

POLITIKE 26 Shtator12:41

Berisha kritikon ashpër fjalimin e Ramës në OKB: Përfaqësimi më i turpshëm në histori, nuk përmendi as Kosovën e UÇK-në

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka lëshuar akuza të forta ndaj Kryeministrit Edi Rama lidhur me fjalimin e tij të mbajtur në...

POLITIKE 26 Shtator12:29

"U emërua në atë post jashtë çdo kriteri", Berisha për skandalin e SHISH-it: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë reston bashkëpunëtorëve që e tradhtuan

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, gjatë një bashkëbisedimi me qytetarët në rrjetet sociale, e ka cilësuar javë...

POLITIKE 25 Shtator22:40

Sulmi me vezë ndaj Ramës në Nju Jork jehonë edhe në mediat e mëdha greke

Tensionet u ndezën gjatë mbërritjes së Edi Ramës në Asamblenë e 81-të të Përgjithshme të OKB-së, ndë...

ME TE VIZITUARAT

SHOWBIZ 25 Shtator

"Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar", Robert...

Roberto Carlos ka rrëfyer një nga periudhat më të errëta të jetës së tij, duke zbuluar kalvarin me të cilin u përball...

AKTUALITET 26 Shtator

E TRISHTE/ Këta janë Flori dhe Florida, vëlla e...

Personat që shihni në foto janë Flori dhe Florida Hoxha, motër e vëlla, të cilët humbën jetën tragjikisht pas shp...

AKTUALITET 25 Shtator

Zbardhet lista/ 44 restorantet ku u tregtua dja...

Pas alarmit të dhënë për hyrjen në Shqipëri të një loti të kontaminuar djathi "Brie" nga Italia, zbardhet nga media...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



Haris Vongli: Dua te kthehem ne Shqiperi per Davidin, tim bir.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.